



## **Kosova Demokratik Turk Partisi ( KDTP )**

**Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur**

**01 Janar 2020 - 31 Dhjetor 2020**



**Përbajtja:**

Raport i auditorëve të Pavarur.....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	5
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	6
Shënimet e pasqyrave financiare.....	7-14



## Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Kosova Demokrat Turk Partisi

### Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

#### Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Kosova Demokratik Turk Partisi (në vijim referuar si "Subjekti Politik" apo "KDTP"), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2020, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin qe përfundon me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqe 6-14.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve për çështjet e përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2020, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin qe përfundon me këtë date, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

#### Bazat për opinion te kualifikuar

- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin 5 Toka, objektet dhe pajisjet te pasqyrave financiare përcjellëse, Subjekti Politik ka prezantuar pasuri ne vlore 8,966.00 EURO me 31 Dhjetor 2020. Subjekti politikë nuk posedon evidencë dhe dokumentacion mbështetës për vlerën 1,577.27 EURO te aseteve te deklaruara prandaj ne nuk ishim ne gjendje te vlerësojmë saktësinë, ekziston plotësinë dhe vlerën e aseteve te prezantuara (31 Dhjetor 2019; 2,262.07 EURO)
- Gjate auditimit tonë ne kemi konstatuar qe Subjekti Politik për shpenzimet e qirasë ne vlore 14,030 Euro nuk ka ndal tatimin ne burim ne qira, sipas kërkesave ligjore qe burojnë nga Ligji NR:05/L-028 për tatimin e mbajtur ne burim , nenı-39.
- SP ka paguar paga dhe kompensime ne vlore 1,717.00 EURO, por që nuk janë përllogaritur dhe dekluaruar tatimet dhe kontributet si tatim në burim bazuar në Ligjin Nr.05/L-28 për Tatimin në të Ardhura Personale sipas kërkesës nga nenı 7 i ligjit . Po ashtu shpenzimet e pagave te prezantuara ne pasqyrat financiare nuk përputhen me ato te deklaruara ne Administratën tatimore te Kosovës për vlerën 1,464.86 EURO.
- Gjate auditimit tonë ne kemi konstatuar qe subjekti politikë nga fondet e pranuara ka dhënë ndihma për te tjerët ne vlore 2,667.00 EURO, duke vepruar kështu ne kundërshtim me Nenin 11 të Ligjit Nr. 03/L-174-tetor 2010, "Për financimin e subjekteve politike" i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjet Nr.04/L-058-janar 2012. dhe Ligjin Nr. 04/L-212-gusht 2013.
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2. Shpenzimet, të Pasqyrave Financiare përcjellëse, subjekti politik ka dekluaruar nen kategorinë "Shpenzimet e Transportit" vlerën prej 2,083.07 Euro për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2020. Pas parasysh natyrën e shënimive qe mban subjekti politik dhe ne mungese te dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse shpenzimet e raportuara janë të sakta dhe prezantojnë drejt aktivitetin e SP KDTP.



Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tonë sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej ne paragrafin “Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”. Ne jemi të pavarur nga Subjekti Politik në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkeshat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përbushur përgjegjësitë tonë të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazë për opinionin tonë.

### Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar me tej opinionin ton ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik ne blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure te tenderimit e cila do te mundësonë një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organizit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nen 17 Kontrolli i Brendshëm.

### Përgjegjësia e drejtuesve dhe e atyre te ngarkuar me udhëheqjen e SP për Pasqyrat Financiare

Drejtuesit e Subjektit politik janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnjë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës se kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përvèç nëse drejtimi synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përvèç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP-së.



### Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përporthje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticitzmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjafueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyesh mërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimitarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në reportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimitarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjera, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit&Conto sh.p.k

Mexhid Aliu  
Auditor ligjor  
6 Totor 2021



**Kosova Demokrat Turk Partisi**  
**Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020**

**Pasqyra e Pozitës Financiare**

<b>Pasuritë</b>	Shënim	<b>Me 31 Dhjetor 2020</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019</b>
		<b>Shuma në Euro</b>	<b>Shuma në Euro</b>
Toka, objektet dhe pajisjet	5	8,966.00	10,062.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>8,966.00</b>	<b>10,062.00</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme		0	0
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	6,241.10	4,534.37
Pasuritë tjera afatshkurtra			
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>6,241.10</b>	<b>4,534.37</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>15,207.10</b>	<b>14,596.37</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluara		4,534.37	23,464.35
Suficiti / (deficiti) i vitit		(992.44)	(18,929.98)
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>3,541.93</b>	<b>4,534.37</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyra	5	8,966.00	10,062.00
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>8,966.00</b>	<b>10,062.00</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8		
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9		
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>			
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>8,966.00</b>	<b>10,062.00</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>15,207.10</b>	<b>14,596.37</b>

**Kosova Demokrat Türk Partisi**  
**Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020**

**Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**

	Shënim	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2020	2019
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga buxheti		63,000.00	63,000.00
Të hyrat nga anëtarësia		1,476.20	
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	0.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyra	5	3,135.00	3,135.00
Të hyrat tjera			
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>67,611.20</b>	<b>66,135.00</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe kompensimet	2	32,637.94	11,596.81
Shpenzimet e transportit	2	4,327.77	2,783.54
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	2,309.84	16,992.32
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	33,736.94
Blerja e mallrave	2	2,039.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	19,470.39	19,138.91
Shpenzimet e ndryshme	2	7,818.70	816.46
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>68,603.64</b>	<b>85,064.98</b>
<b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>		<b>(992.44)</b>	<b>(18,929.98)</b>

**Kosova Demokrat Turk Partisi**  
*Shënimë për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020*

---

## **1. Informata te përgjithshme**

Kosova Demokratik Turk Partesi KDTP  
E themeluar: 2001  
Kryetar : Mahir Jagcilar

Zyrtar finanziar: Sezer Hoti

Adresa: Prizren

Pasqyrat financiare te KDTP-së janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, nen 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vëtme bankare ne bankën: NLB.

**Kosova Demokrat Turk Partisi**

*Shënimë për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020*

**Shënim i 2. Shpenzimet**

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto	27,262.40	27,262.40	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	1,308.75	1,211.52	97.23
Kontributet pensionale të punëdhënësit	1,308.75	1,211.52	97.23
Tatimet në të ardhura personale	1,041.04	931.34	109.70
Beneficionet tjera	1,717.00	1,717.00	0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>32,637.94</b>	<b>32,333.77</b>	<b>304.17</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	2,083.07	2,083.07	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.	1,340.00	1,340.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	904.70	904.70	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>4,327.77</b>	<b>4,327.77</b>	<b>0.00</b>
<b>Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
Lokali			
Ushqimi	1,609.87	1,609.87	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta			0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	699.97	699.97	0.00
<b>Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>2,309.84</b>	<b>2,309.84</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e fushatës</b>			

**Kosova Demokrat Turk Partisi**

*Shënimë për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020*

<b>Shpenzimet e fushatës</b>			
<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>			
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës	2,039.00	2,039.00	0.00
Pajisjet të vogla			0.00
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>2,039.00</b>	<b>2,039.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës	14,030.00	11,635.00	2,395.00
Telefoni, interneti dhe posta	792.47	792.47	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	1,512.92	1,512.92	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	3,135.00	//////////	//////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime		//////////	//////////
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>19,470.39</b>	<b>13,940.39</b>	<b>2,395.00</b>
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	1,673.05	1,673.05	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjeter	6,145.65	6,145.65	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>7,818.70</b>	<b>7,818.70</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>68,603.64</b>	<b>62,769.47</b>	<b>2,699.17</b>

**Kosova Demokrat Turk Partisi**  
**Shënimë për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020**

**Shënim i 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
<b>Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla</b>						

**Shënim i 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime**

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Vlera në euro	
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	
<b>Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime</b>					

**Kosova Demokrat Turk Partisi***Shënimë për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020***Shënim 5: Toka, objektet dhe pajisjet**

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fund të vitit (vlera neto)
Toka					
Objektet					
Veturat	24,500.00		16,700.00	2,450.00	<b>5,350.00</b>
Pajisjet e zyrës	5,318.00	2,039.00	3,425.00	532.00	<b>3,400.00</b>
Pajisjet e teknologjisë informative	1,532.00		1,163.00	153.00	<b>216.00</b>
Pajisjet tjera					<b>0.00</b>
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b>	<b>31,350.00</b>	<b>2,039.00</b>	<b>21,288.00</b>	<b>3,135.00</b>	<b>8,966.00</b>

**Shënim tjetër**

Shënim 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2017 Shuma në Euro
Llogari te arketueshme		
<b>Gjithsej Llogarit e arkëtueshme</b>	//////////	///////////

Shënim 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro
Paraja në bankë	5,391.70	4,534.37
Paraja në arkë	849.40	
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>6,241.10</b>	<b>4,534.37</b>

**Kosova Demokrat Turk Partisi***Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020*

<b>Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro</b>
Furnitor vendor		
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>//////////</b>	<b>//////////</b>

<b>Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro</b>
Detyrimet për paga dhe tatime	304.17	
Detyrimet për qira	2,395.00	
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>2,699.17</b>	<b>0.00</b>

Kosova Demokrat Turk Partisi

Shënim i përpasqyrat Financiare 01 Janar 2020 deri më 31 Dhjetor, 2020

Shënim i 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Paguar ndaj:			Vlera në euro
	Personi Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal	
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro				/     /     /     /     /